



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial**  
**Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.27 të Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 83 dt. 29 tetor 2010 dhe nenit 3 dhe 4 të Ligjit nr.05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 17 dt. 30 qershor 2015, në takimin e mbajtur më datë 29 dhjetor 2015, miraton këtë:

**RREGULLORE NR. 09/2015**

**PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT DHE ZËVENDËS KRYESUESIT TË KËSHILLIT**  
**PROKURORIAL TË KOSOVËS**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore rregullon procedurën e zgjedhjes së Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të KPK-së.
2. Procesi i zgjedhjes së Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të KPK-së është i hapur, transparent, i paanshëm dhe objektiv. Procesi zbatohet në pajtim me parimet e konkurrencës.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

"KPK" .....nënkupton Këshilli Prokurorial i Kosovës.

**Neni 3**

**Parimet e përgjithshme për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të KPK-së**

KPK siguron që procesi për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të KPK-së të jetë transparent, i paanshëm dhe objektiv.

#### **Neni 4**

##### **Procedura për paraqitjen e nominimeve**

1. Kryeprokurori i Shtetit i dërgon thirrjen për paraqitjen e nominimeve të gjithë anëtarëve të KPK-së.
2. Të gjithë anëtarët e KPK-së të cilët dëshirojnë të kandidojnë për pozitën e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të KPK-së duhet që përmes emailit t'ia dorëzojnë nominimin e tyre zyrtar Kryeprokurorit të Shtetit jo më vonë se tri ditë pune nga thirrja për paraqitjen e nominimeve nga paragrafi 1 i këtij neni. Secili kandidat duhet ta specifikojë pozitën për të cilën ai apo ajo e paraqet nominimin. Kandidati ka të drejtë që të paraqesë nominimin për të dyja pozitat.
3. Secilit kandidat që paraqet nominimin zyrtar do t'i dërgohet një email me konfirmimin e pranimit të nominimit brenda dyzet e tetë (48) orësh.

#### **Neni 5**

##### **Procedura për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të KPK-së**

1. Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të KPK-së bëhet në mbledhjen e parë të përbërjes së re të KPK-së.
2. Deri në zgjedhjen e Kryesuesit të ri, mbledhjet e KPK-së drejtohen nga Kryeprokurori i Shtetit.
3. Kryeprokurori i Shtetit si kryesues i mbledhjes i jep mundësinë secilit kandidat që brenda një kohe të arsyeshme të elaborojë shkaqet e kandidimit para anëtarëve tjerë të KPK-së. Kryesuesi ua jep këtë mundësi kandidatëve sipas radhës alfabetike. Kryesuesi ka të drejtë që t'ia ndërpresë fjalën kandidatit nëse kandidati bën komente poshtëruese për kundërkandidatët tjerë apo nëse kandidati e zgjat fjalën përtej një kohe të arsyeshme.
4. Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi i KPK-së zgjedhen me votim të fshehtë. Secili anëtar i KPK-së ka të drejtë që të votojë vetëm për një kandidat për secilën pozitë. Së pari bëhet votimi për Kryesues, e pastaj për Zëvendës Kryesues.
5. Zgjedhja e kandidatëve bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë të KPK-së.
6. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3), votimi përsëritet vetëm për dy kandidatët të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave.

7. Kandidatët të cilët marrin shumicën prej dy të tretave (2/3) në votimin e përsëritur zgjidhen për pozitat përkatëse.

8. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në votimin e përsëritur, votimi ripërsëritet. Kandidati i cili në votimin e ripërsëritur merr shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm që votojnë, zgjedhet për pozitën përkatëse.

9. Nëse kandidatët kanë numër të njëjtë të votave pas ripërsëritjes së votimit, zgjedhja bëhet me short.

**Neni 6**  
**Prania e mediave gjatë procesit të votimit**

Prania e anëtarëve të mediave për vëzhgim gjatë procesit të votimit lejohet. Fotografimi dhe incizimet audio apo video ndalohen.

**Neni 7**  
**Dispozitat kalimtare**

Kryeprokurori i Shtetit e thërret dhe kryeson mbledhjen e KPK-së deri në zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesi të ri.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KPK.

Prishtinë, 29 dhjetor 2015

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Kryesues, Aleksandër Lumezi

